



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

---

Numri i lëndës: 2024:223845

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06094287

PPP.nr.46/24

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtorin profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në lëndën përmbarese të kreditorëve Xh.S, K.B-R dhe V.B-D, që të tre nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson i autorizuari Av. S.M nga Prizreni, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson i autorizuari Zyrtari Ligjor, V.G, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër urdhërit të përmbaresit privat R.H nga Prizreni P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024, më 28.08.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, i paraqitur kundër urdhërit të përmbaresit privat R.H nga Prizreni, P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorëve Xh.S, K.B-R dhe V.B-D, që të tre nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, në bazë të dokumentit përmbarimorë, Aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Gjakovë dega në Rahovec C.nr.1209/2023 i datës 15.05.2024.
- II. MBETET NË FUQI urdhëri i përmbaresit privat R.H nga Prizreni P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024.

## A r s y e t i m

Në bazë të propozimit të kreditorëve Xh.S, K.B-R dhe V.B-D, që të tre nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, përmbaruesi privat R.H nga Prizreni, ka lejuar përmbarimin sipas urdhrit P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024, në bazë të dokumentit përmbarimor, C.nr.1209/2023 i datës 15.05.2024, i plotfuqishëm me datë 19.06.2024, i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në shumën e përgjithshme prej 238.00 euro.

Kundër urdhrit me të cilin është caktuar përmbarim, debitori Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ka paraqitur prapësim me të cilin ka kundërshtuar urdhrin për caktimin e përmbarimit, pasi që sipas tij, debitori Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, nuk është e detyruar të kryej detyrimin, por për këtë obligim duhet të obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Duke shtuar se propozimi për përmbarim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të LPP-së, ndërsa duke u bazuar në Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të datës 04.02.202, e njëjta ka vlerësuar se: “ *Përmbarimi i dokumenteve përmbarimore nga ana e gjykatës dhe kërkesat materiale është në pajtim me parimin e mbrojtjes së debitorit që nënkupton se procedura e përmbarimit duhet të realizohet me sa më pak shpenzime në mënyrë që të mos ngarkohet pozita e debitorit*”. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovoj prapësimin e debitorëve dhe të shfuqizoi urdhërin përmbarimor.

Kreditorët brenda afatit ligjor kanë ushtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazë, me arsyetimin se kundërshtimi i debitorit nuk mbështetet në asnjë bazë ligjore. Duke shtuar se dokumenti përmbarues është i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm konform nenit 177 par.1 të LPP-së. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzojë si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditorëve, urdhërit për lejimin e përmbarimit, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim të kreditorëve, shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është i pabazuar.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-139 (i publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.3 të dt.31.01.2013, më tej LPP) në nenin 21 përcaktohen bazat juridike për caktimin e përmbarimit, “*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 22 par.1 nënpar.1.1 përcaktohet se “*1. Dokumente përmbaruese janë: 1.1“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese”*”.

Gjykata me analizimin dhe shikimin e dokumenti përmbarues – Aktgjykimi C.nr.1209/2023 i datës 15.05.2024, vërtetoi faktin se debitori ka qenë i obliguar për shkak të detyrimit në të holla emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguaj shumë e përgjithshme prej 238.00

euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykim. Debitori me asnjë prove nuk arriti të vërtetoj faktin se ka kryer pagesën për këtë shumë. Gjykata po ashtu ka vërtetuar faktin se dokumenti përmbarimor – Aktgjykimi C.nr.1209/2023 i datës 15.05.2024, i dhënë në procedurë gjyqësore është nxjerrë nga organi kompetent, ka marrë formën e prerë me datë 19.06.2024, si dhe i njëjti është i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024,. Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se *"Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit"*. Nga kjo rezulton se vendimi në fjalë është titull përmbarimor për shkak se e ka të përcaktuar kreditorët dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, si dhe shumën e përmbushjes, andaj si i tillë është i përshtatshme për përmbarim, dhe gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi urdhërin përmbarimor P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024.

Gjykata analizoi kundërshtimet e debitorit lidhur me urdhërit për lejimin e përmbarimit P.nr.1274/24, të datës 22.07.2024, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të pabazuar, sepse gjykata në procedurën përmbarimore nuk lëshohet në ligjshmërinë materiale të dokumentit përmbarues, në bazë të të cilit kërkohet përmbarimi. Gjykata në procedurën përmbarimore kujdeset se a është bërë propozimi për përmbarim dhe a është lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarues siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastin konkret përmbarimi është lejuar në bazë dokumenti përmbarimor Aktgjykim, C.nr.1209/2023 i datës 15.05.2024, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, dega në Rahovec, i plotfuqishëm me datë 19.06.2024, i ekzekutueshëm nga data 27.06.2024, ndërsa kreditorët propozimin për përmbarim e kanë parashtruar me datë 22.07.2024, brenda afatit sipas të cilit mund kërkohet përmbarimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22, 23, 24 par.1 dhe 27 lidhur me nenin 73, 77 par.1 dhe 5 dhe nenit 290 të Ligjit mbi Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË -DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,  
PPP.nr.46/24, dt. 28.08.2024

B. Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate Themelore.